




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-0/DPK
Dep.	02
Nr. fletë	Nr. Prot.
Broj stranica	Br. Prot.
Nr. pages	Prot. No.
	01-4137/12
	14-11-2012
MINISTERI	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
 ANTI – CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **08.11.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-2430/12, për ztr. *Avni Kastrati* – Kryetar i Komunës së Mitrovicës, për shkak se ështëshmangur situata me konflikt interesit në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihaqet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-2430-12, për Zyrtarin e lartë, ztr. Avni Kastrati – Kryetar Komune në Mitrovicë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas fillimit të procedurës për rastin (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), në të cilën është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në disa biznes private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, konsiderohet papajtushmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkresë njoftuese, me zyrtarin e lartë, ztr.Kastrati është mbajtur një takim me zyrtarët e Agjencisë, gjatë të cilit është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyrën e shmangies së saj.

Zyrtari i lartë, ztr. Avni Kastrati ka dekluaruar se do të filloj procedurat e ndryshimit të kësaj gjendje, konform Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, në ushtrimin e funksionit publik.

Pas kësaj, zyrtari i lartë, ztr.Kastrati, ka njoftuar se është tërhequr nga funksioni i personit të autorizuar dhe menaxhues në ndërrmarrjet private, me c'rast ka emruar një person te besueshëm, dhe vazhdon ta kryej vetëm funksionin e vet publik si Kryetar Komune në Mitrovicë.

Për ndryshimet e bëra në këtë biznes, Agjencia kundër Korrupsionit, ka pranuar nga vet ztr.Kastrati, edhe dokumente zyrtare nga ARBK-ja, me informacionet e reja mbi biznesin "Eko Kosovai" sh.p.k (DPK/DPKI-03-3993/12), dhe "Oil – Trade" Sh.p.k. (DPK/DPKI-03-3994/12) në të cilat shihet se ai, tashmë, nuk ushtron funksion menaxhues në këto biznese, ndërsa te biznesi "Amar" sh.p.k. (DPK/DPKI-03-3995/12) ka heq dorë fare nga çdo funksion.

Në bazë të këtyre dokumenteve zyrtare, dhe Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit (Nr.04/L-051), kemi konstatuar se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Prteni /

